



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 20

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.151, datë 13.3.2003	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të porteve të peshkimit në Vlorë dhe në Sarandë dhe për miratimin e marrëveshjes tip, të kalimit në përdorim të porteve të peshkimit tek Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP).....	601
Vendim i KM nr.155, datë 13.3.2003	Për përballimin e shpenzimeve të atashëve ushtarakë dhe oficerëve të forcave të armatosura, që shërbejnë në shtabet e Nato-s.....	608
Vendim i KM nr. 159, datë 13.3.2003	Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe për procedurat e shitjes.....	610
Vendim i KM nr.166, datë 13.3.2003	Për disa shtesa në vendimin nr.506, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i kryqëzimit në zonën e plepave, Durrës, pjesë e segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë”.....	619
Vendim i KM nr.169, datë 13.3.2003	Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore që i nënshtrohen	

	privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare.....	620
Vendim i KM nr.172, datë 13.3.2003	Për disa shtesa në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.....	624
Vendim i KM nr.184, datë 20.3.2003	Për rregullat dhe veprimet e zyrave të gjendjes civile dhe për detyrimin e shtetasve për transferimin e të dhënave të gjendjes civile.....	625
Vendim i KM nr.187, datë 20.3.2003	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Librazhd-Qukës, në qarkun e Elbasanit.....	628
Vendim i KM nr.188, datë 20.3.2003	Për miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për vitin 2003.....	629
Vendim i KM nr.189, datë 20.3.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve në Shërbimin Informativ Shtetëror”.....	630
Vendim i KM nr.190, datë 20.3.2003	Për përcaktimin e kufijve të sasisë së farërave, që lejohen të shkëmbehen për qëllime shkencore dhe eksperimentale, si dhe ato që ndalohen të shkëmbehen për këtë qëllim.....	630
Udhëzim i MF nr.8, datë 17.2.2003	Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj.....	632
Urdhër i MBU nr.17, datë 15.1.2003	Për miratimin e Statutit të Organizatës së Peshkimit (OMP Pogradec).....	637

V E N D I M
Nr.151, datë 13.3.2003

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PORTEVE TË
PESHKIMIT NË VLORË DHE NË SARANDË DHE PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
TIP, TË KALIMIT NË PËRDORIM TË PORTEVE TË PESHKIMIT TEK ORGANIZATAT E
MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të pikës 3, të nenit 31/11 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Hauzi i peshkimit në Treport dhe pjesa e portit të peshkimit në Limjon, së bashku me infrastrukturën përkatëse, sipas genplaneve që i bashkëlidhen këtij vendimi, të kalojnë, përkatësisht, nga porti detar Vlorë sh.a. dhe porti detar Sarandë sh.a., në administrim të ndërmarrjes së rritjes së midhjes Sarandë, e cila është në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.
2. Miratimin e marrëveshjes tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për kalimin në përdorim të porteve të peshkimit tek Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP).
3. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
TIP PËR TRANSFERIMIN NË PËRDORIM TË PORTIT TË PESHKIMIT

Në zbatim të ligjit nr.8870, datë 21.3.2002 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, lidhet kjo Marrëveshje ndërmjet ndërmarrjes së rritjes së midhjes Sarandë dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) për transferimin në përdorim të portit të peshkimit Sarandë, mbi bazën e kushteve të pranuar nga palët dhe të përshkruara në nenet e mëposhtme.

Neni 1
Palët

Palët në këtë Marrëveshje janë ndërmarrja e rritjes së midhjes Sarandë dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), person juridik i krijuar në mbështetje të nenit 26 të Kodit Civil për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e peshkimit, në përputhje me përcaktimet e parashikuara në ligjin nr.8870, datë 21.3.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën””.

Neni 2
Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është transferimi i përdorimit të portit të peshkimit nga ndërmarrja e rritjes së midhjes Sarandë tek OMP-ja..... , duke përcaktuar kushtet për kryerjen e veprimtarive në port, si edhe kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Palëve.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje ndërmjet Palëve të lartpërmendura lidhet për një afat prej 30 vjetësh me të drejtë rinovimi të saj.

Neni 4
Pronësia

1. Porti i peshkimit është pronë publike, i cili transferohet dhe i jepet në përdorim OMP-së.
2. Ndërmarrja e rritjes së midhjes Sarandë është përfaqësuesi i shtetit në marrëdhëniet e pronësisë.
3. OMP-ja është pronare e mjeteve dhe pajisjeve që ka investuar në territorin e portit të peshkimit.

Neni 5
Territori i portit që transferohet në përdorim

1. OMP-së i transferohet në përdorim hapësira ujore dhe ajo tokësore e portit të peshkimit nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, mbi bazën e kufijve të përcaktuar në genplanin bashkëngjitur vendimit të Këshillit të Ministrave.
2. OMP-ja garanton rrethimin dhe ruajtjen e territorit të portit të peshkimit.

Neni 6
Veprimtaritë kryesore që kryhen në portin e peshkimit

1. Veprimtaritë që kryhen në portin e peshkimit përfshijnë strehimin, përpunimin dhe shërbimet teknike të anijeve të peshkimit.
2. OMP-ja programon dhe merr masa për vendosjen e sigurt të anijeve të peshkimit në kalata,

duke respektuar rregullat dhe rregulloret e hartuara për këtë qëllim.

3. OMP-ja krijon kushte për përpunimin e anijeve të peshkimit në port (shkarkimin e peshkut të zënë, furnizimin me karburant, me ujë të pijshëm dhe bazë materiale e teknike të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit).

4. OMP-ja krijon kushte për kryerjen e shërbimeve të nevojshme të anijeve të peshkimit (riparime të pajisjeve e agregateve të tyre), duke përdorur në mënyrë racionale territorin dhe infrastrukturën që administron.

Neni 7

Ruajtja e destinacionit dhe e interesit publik

1. OMP-ja me marrjen në administrim të portit dhe të strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit, garanton mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit për të cilin i është transferuar administrimi i këtij porti.

2. OMP-ja merr përsipër që në administrimin e portit të peshkimit të ruajë dhe të garantojë interesin publik.

3. OMP-ja ka të drejtën ekskluzive të menaxhimit të portit të peshkimit që ka në përdorim.

Neni 8

Përdorimi i portit në rastet e jashtëzakonshme

OMP-ja merr përsipër të garantojë përdorimin e portit të peshkimit nga ana e shtetit në rastet e masave të jashtëzakonshme, të përcaktuara me ligj të veçantë.

Neni 9

Ruajtja dhe rritja e vlerës ekonomike

OMP-ja merr përsipër që jo vetëm të ruajë e mirëmbajë portin, por edhe të ndikojë në rritjen e vlerës ekonomike të strukturave portuale të peshkimit që i janë dhënë në përdorim.

Neni 10

Përgjegjësitë e OMP-së

1. OMP-ja është përgjegjëse për shfrytëzimin racional të portit, në mënyrë që të sigurojë mbështetjen e zhvillimit normal të veprimtarisë së peshkimit.

2. OMP-ja merr përsipër përballimin e kostove të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së portit.

3. OMP-ja përgjigjet për mirëmbajtjen e portit të peshkimit, ku përfshihen:

- a) mirëmbajtja e ndërtesave të administratës dhe të reparteve ndihmëse;
- b) shërbimet e mbledhjes së mbeturinave të lëngëta dhe solide në territorin e portit;
- c) mirëmbajtjen e infrastrukturës për furnizim me energji elektrike, karburante dhe ujë të pijshëm;
- d) mirëmbajtjen e mjediseve higjieno-sanitare të portit etj.

Neni 11

Përgjegjësitë e palës shtetërore

Përfaqësuesi i palës shtetërore në çdo kohë të praktikueshme duhet të mbajë të hapur kanalin e hyrjes, si edhe të bëjë përf forcimin e strukturave mbrojtëse dallgëthyesë të portit.

Neni 12

Mbrojtja e interesave të përdoruesve

OMP-ja merr përsipër që të përdorë në mënyrë të drejtë e të barabartë për të gjithë anëtarët portin e peshkimit, në mënyrë që të nxisë dhe të mbrojë interesat e përdoruesve.

Neni 13
Mbrojtja e mjedisit

OMP-ja merr përsipër që të administrojë portin e peshkimit në mënyrë racionale, duke zbatuar legjislationin në fuqi, për të nxitur mbrojtjen e mjedisit dhe një zhvillim të qëndrueshëm.

Neni 14
Inspektimi

OMP-ja merr përsipër të krijojë të gjitha kushtet për inspektimin nga ana e organeve shtetërore, të ngarkuara nga ligji, të portit dhe të strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit që ajo administron.

Neni 15
Përdorimi i portit të peshkimit nga persona joanëtarë të OMP-së

1. OMP-ja është e detyruar të lejojë çdo mjet lundrues, që është pronë ose drejtohet nga një person i cili nuk është anëtar i OMP-së, të përdorë portin e peshkimit që i është transferuar OMP-së në përputhje me rregullat e vendosura prej saj.

2. Mundësia për të hyrë në zonën e portit të peshkimit u krijohet të gjithë personave fizikë e juridikë, qytetarëve shqiptarë dhe të huaj, që kanë leje hyrjeje të lëshuar nga

OMP-ja. Kufizimet e hyrjeve në port OMP-ja i mbështet në konventat kombëtare e ndërkombëtare për të parandaluar veprime të paligjshme ose aksidente.

3. Personat joanëtarë të OMP-së, të cilët hyjnë ose shfrytëzojnë portin e peshkimit që i është transferuar asaj OMP-je, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e portit dhe me rregulloret e OMP-së.

Neni 16
Marrëdhëniet e OMP-së me organet shtetërore

1. Marrëdhëniet e OMP-së me organet shtetërore rregullohen mbi bazën e legjislationit për autoritetet portuale.

2. OMP-ja mban lidhje të rregullta dhe të vazhdueshme me organet shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë në zonën e portit (kapiteneria, regjistri, policia, dogana etj.).

3. OMP-ja është përgjegjëse për sigurinë dhe sigurimin në territorin e portit të peshkimit që ka në administrim.

4. Kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrës së kapitenerisë së portit ndaj anijeve të peshkimit, ekuipazheve të tyre dhe koordinimit të veprimtarive të lundrimit rregullohen mbi bazën e ligjeve në fuqi dhe të Kodit Detar. OMP-ja bashkëpunon ngushtë me kapitenerinë si në drejtim të këmbimit të informacionit të mbërritjes e largimit të anijeve, ashtu edhe për lëvizjen e anijeve brenda portit.

5. OMP-ja bashkëpunon ngushtë me kapitenerinë dhe regjistrin detar për ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve që lidhen me sigurimin e lundrimit të anijeve mbi bazën e konventave ndërkombëtare.

6. OMP-ja bashkëpunon dhe i krijon kushtet e duhura doganës në mënyrë që ajo të kryejë detyrat funksionale të saj brenda territorit të portit të peshkimit.

7. OMP-ja bashkëpunon me policinë, me qëllim që të sigurojë zhvillimin normal të veprimtarive në portin e peshkimit.

Neni 17
Dokumentacioni i OMP-së

1. Dokumentacioni i Marrëveshjes së transferimit të portit të peshkimit Sarandë mbahet në ndërmarrjen e rritjes së midhjes Sarandë, në OMP dhe kopje të saj i dërgohen Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Ndërmarrja e rritjes së midhjes dhe OMP-ja kryejnë inventarin e portit të peshkimit, të cilin

OMP-ja e merr në ngarkim së bashku me dokumentacionet përkatëse.

Neni 18

Anulimi i Marrëveshjes

Anulimi i Marrëveshjes bëhet në këto raste:

- a) kur OMP-ja shpërndahet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit;
- b) kur OMP-ja ndryshon destinacionin dhe qëllimin e përdorimit të portit, të përcaktuar sipas kësaj Marrëveshjeje;
- c) kur OMP-ja nuk merr përsipër të vazhdojë administrimin e portit sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;
- d) kur mosmarrëveshjet ndërmjet OMP-së dhe ndërmarrjes së rritjes së midhjes Sarandë nuk gjejnë zgjidhje në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 19

Nënshkrimi

1. Kjo Marrëveshje nënshkruhet nga Drejtori i ndërmarrjes së rritjes së midhjes Sarandë dhe nga Kryetari i OMP-së, si përfaqësues të palëve.
2. Marrëveshja hyn në fuqi pas miratimit nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

V E N D I M

Nr.155, datë 13.3.2003

PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ATASHEVE USHTARAKË DHE OFICERËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, QË SHËRBEJNË NË SHTABET E NATO-S

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- I. Për shpenzimet për atashetë ushtarakë të akredituar në vende të tjera
 1. Ministria e Mbrojtjes të përballojë brenda fondeve buxhetore vjetore, shpenzimet e atashëve ushtarakë të akredituar në vende të tjera për veprimtaritë e veçanta, që kanë të bëjnë me:
 - shpenzimet publicitare në interes të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
 - shpenzimet për udhëtime dhe dieta brenda vendit pritës;
 - shpenzimet për karburant;
 - shpenzimet për udhëtime dhe dieta jashtë vendit pritës, kur këto kryhen në interes të Ministrisë së Mbrojtjes;
 - shpenzimet për pritje të partnerëve zyrtarë, në vendin pritës;
 - shpenzimet për ceremoni zyrtare të karakterit ushtarak, të vendit pritës;
 - shpenzimet për pritje të personelit ushtarak të nivelit të lartë;
 - shpenzimet për uniformën;
 - shpenzimet për mbështetjen e veprimtarive, veçanërisht të rëndësishme, të studentëve ushtarakë shqiptarë, në vendet përkatëse.
 2. Për efekt të pagesës së alokacionit, grada e atashëve ushtarak njësohet me gradën e ministrit këshilltar.
- II. Shpenzimet për ushtarakët shqiptarë, që shërbejnë në shtabet e NATO-s

1. Ministria e Mbrojtjes të përballojë shpenzimet për kryerjen e veprimtarisë së oficerëve shqiptarë që shërbejnë në shtabet e NATO-s.

2. Ushtarakët shqiptarë, për kohën që shërbejnë në shtabet e NATO-s, përveç alokacionit, përfitojnë edhe pagën përkatëse (pagë klase, shtesë vjetërsie dhe shpërblim mbi pagën), që kanë në çastin e transferimit ose të emërimit.

3. Alokacioni fillon të paguhet ditën e arritjes së ushtarakut në zyrat e shtabit të NATO-s dhe ndërpritet pas mbarimit të misionit.

4. Ushtaraku aktiv kur shkon për herë të parë në zyrat e shtabit të NATO-s merr si paradhënie në valutë alokacionin për 15 ditë, të cilin e shlyen brenda 6 muajve nga dita e fillimit të detyrës. Nëse transferohet në atdhe para mbarimit të këtij afati, kundërvlerën e paradhënies së mbetur e shlyen në lekë, sipas kursit të shkëmbimit të valutave, brenda 6 muajve pas kthimit në atdhe.

5. Kur ushtaraku aktiv dërgohet me shërbim jashtë venddislokimit të komandës ose kur vjen në atdhe, por në shtetin ku kryen detyrën ka lënë bashkëshorten dhe fëmijët, këta të fundit marrin 100 për qind të alokacionit.

6. Kur ushtaraku aktiv shtrohet për kurim në institucionet shëndetësore të shtetit, ku ndodhet komanda ose shtabi i NATO-s, ose në ndonjë shtet tjetër, merr 80 për qind të alokacionit.

7. Ushtaraku aktiv gëzon të drejtën e pushimeve javore, pushimeve në ditët e festave zyrtare dhe pushimin vjetor të paguar, për kohën që është me detyrë jashtë shtetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shteti nuk merr përsipër shpenzimet për ushtarakun, kur ai kthehet në atdhe për të bërë lejen e zakonshme. Me miratimin e Ministrit të Mbrojtjes, për raste të veçanta (vetëm për fatkeqësi) për ushtarakun dhe bashkëshorten, paguhet nga shteti vetëm shpenzimet e udhëtimit (për ardhjen në atdhe dhe kthimin në vendin e huaj).

8. Punësimi i bashkëshortes së ushtarakut aktiv, bëhet vetëm me miratimin e Ministrit të Mbrojtjes. Në rastet e punësimit të bashkëshortes jashtë misionit, alokacionit të ushtarakut i bëhet zbritje 30 për qind, ndërsa në rastin kur bashkëshortja punësohet në punë të ndryshme në mision dhe merr një shpërblim deri në 40 për qind të funksionit që kryen, ushtaraku merr 100 për qind të alokacionit.

9. Ushtaraku aktiv për përmbushjen me korrektësi të detyrës, merr një alokacion deri në 15 ditë, kur është ngarkuar me përgjegjësi financiare e materiale dhe deri në 5 ditë për ushtarakët e tjerë.

10. Ministria e Mbrojtjes për këta ushtarakë aktivë, bashkëshortet e tyre si dhe fëmijët parashkollorë, bën sigurimet e detyrueshme sipas legjislacionit të shtetit përkatës, ku ata kryejnë detyrën. Ushtaraku aktiv, bashkëshortja e tij dhe fëmijët parashkollorë kanë të drejtë që, për raste urgjencash, të mjekohen në vendin ku ushtaraku kryen detyrën, me miratimin e eprorit direkt dhe sipas rregullave të shtabit ku ai bën pjesë, kur për një gjë të tillë nuk është parashikuar siguri shëndetësor. Në këtë rast, shpenzimet përballohen nga shteti, ndërsa për rastet e tjera, shpenzimet përballohen nga vetë ushtaraku.

11. Shkallëzimi në përqindje i funksioneve të këtyre ushtarakëve, në raport me nivelin bazë të alokacionit është:

- Nënoficer 170 për qind
- Oficer 190 për qind

12. Masa e alokacionit për nivelin bazë (100 për qind) caktohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes.

13. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet për qira, energji elektrike, ujë, ngrohje e gaz të apartamentit të banimit të ushtarakut, si dhe për kancelari e shpenzime të tjera administrative.

14. Ushtaraku aktiv ka të drejtë të marrë shpenzime udhëtimi, akomodimi dhe dietë në valutë të huaj, sipas legjislacionit në fuqi, kur nga drejtuesi emërohet në detyrë, thirret në atdhe ose dërgohet me shërbim në një shtet tjetër, kthehet në atdhe në përfundim të misionit, si dhe dërgohet me shërbim për nevoja pune nga autoritete drejtuese të NATO-s.

Për rastet e parashikuara në pikën 14 të këtij vendimi, personeli oficer i misionit dhe personeli nënoficer marrin dietën e kategorisë së tretë. Kur ushtaraku shoqërohet nga bashkëshortja, edhe kjo e fundit merr dietën e kategorisë së tretë.

III. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave, që brenda 30 ditëve pas hyrjes në fuqi, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 159, datë 13.3.2003

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHETETËRORE QË PRIVATIZOHET, SI
DHE PËR PROCEDURAT E SHITJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. VLERËSIMI I ELEMENTEVE TË PASURISË

Këtij vendimi i nënshtrohen ndërmarrjet ose objektet e veçuara, mjetet kryesore dhe mjetet e xhiros së ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe institucioneve me kapital tërësisht shtetëror, për të cilat është dhënë miratimi i përfaqësuesit të pronës shtetërore për fillimin e procedurave të privatizimit ose transformimit në shoqëri tregtare.

Vlera aktuale minimale (VAM) për çdo element të pasurisë shtetërore llogaritet duke korrigjuar vlerën kontabël të mbetur me indeksin mujor të çmimit dhe koeficientin e vendndodhjes.

1. Për ndërtesat dhe objektet ndërtimore, që figurojnë si njësi të veçanta të ndërmarrjes, vlera kontabël e mbetur të përcaktohet duke zbritur nga vlera fillestare kontabël shumë e amortizimit (kontabël) të llogaritur, në bazë të viteve të përdorimit dhe normës vjetore të konsumit, që përcaktohet sipas vendimit nr.401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave pjesa “Amortizimi për investimet”.

Përcaktimi i vlerës aktuale minimale bëhet nga grupi i ekspertëve vlerësues, të cilët kërkohen nga komisioni i vlerësimit dhe miratohen nga organi qendror ose pushteti vendor, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes për rastet:

- Kur mungojnë të dhënat:

a) për vlerën fillestare kontabël të objektit;

b) për vlerën fillestare kontabël të objektit të veçuar nga një tërësi me të dhënat e njohura.

Në këto raste, grupi i ekspertëve vlerësues përcakton vlerën fillestare kontabël, duke u mbështetur në gjykimin teknik të gjendjes faktike të objektit, duke përdorur çmime të manualit 1986-1990.

Në këto raste, komisioni i vlerësimit miraton vlerën e përcaktuar nga ekspertët ndërmjet situacionit dhe raportit vlerësues dhe, duke zbritur amortizimin sipas kontabilitetit, përcakton vlerën aktuale minimale duke zbatuar indeksin mujor të çmimit dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Kur mungon viti i vënies në shfrytëzim:

Grupi i ekspertëve vlerësues përcakton amortizimin faktik, duke u bazuar në gjykimin teknik të gjendjes faktike të objektit. Komisioni i vlerësimit përcakton VAM-in, duke zbatuar amortizimin faktik mbi vlerën fillestare kontabël, indeksin mujor të çmimit dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Kur objekti ka dëmtime fizike ose mungesa pjesësh a instalimesh organike, që cenojnë funksionimin e tij:

Ekspertët vlerësues përcaktojnë vlerën fillestare të mungesave ose të dëmtimeve, sipas manualit të çmimeve të vitit 1986-1990. Komisioni i vlerësimit, pasi miraton këtë vlerë llogarit vlerën kontabël të mbetur, duke zbritur nga vlera fillestare kontabël e objektit, vlerën fillestare të mungesave ose dëmtimeve dhe duke zbatuar amortizimin sipas kontabilitetit. VAM-i përcaktohet duke zbatuar indeksin e çmimit mujor, si dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Kur objektit i janë bërë ndreqje ose shtesa, të cilat nuk janë pasqyruar në kontabilitet:

Ekspertët vlerësues përcaktojnë vlerën faktike të tyre me çmimet e manualit 1986-1990. Komisioni i vlerësimit, pasi miraton këtë vlerë llogarit vlerën kontabël të mbetur, duke i shtuar diferencën së vlerës fillestare kontabël me amortizimin përkatës të objektit, vlerën e këtyre ndreqjeve

ose shtesave. VAM-i përcaktohet duke zbatuar indeksin e çmimit mujor, si dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Kur amortizimi kontabël është mbi 100%, por objekti ka vlerë përdorimi:

Ekspertët vlerësues përcaktojnë amortizimin faktik, sipas gjykimit teknik për gjendjen reale të objektit.

- Kur objekti është i dëmtuar mbi 80 % të vlerës:

Kjo masë dëmtimi përcaktohet nga komisioni i vlerësimit, nëpërmjet raportit të vlerësimit, fotografive të objektit etj. Në këtë rast ekspertët llogarisin vlerën faktike të objektit sipas gjykimit teknik për gjendjen reale të tij, nëpërmjet situacionit dhe raportit të vlerësimit, duke përdorur manualin e çmimeve të viteve 1986-1990 dhe duke zbatuar amortizimin sipas kontabilitetit. Komisioni i vlerësimit përcakton VAM-in duke zbatuar indeksin mujor të çmimit dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Për ndërtesat dhe objektet ndërtimore, të vëna në shfrytëzim ose të blera pas vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), vlera kontabël e mbetur do të llogaritet sipas kapitullit të I-rë dhe mbi të zbatohet koeficienti i indeksit të çmimeve, që del nga raporti ndërmjet dy indekseve (të periudhës së vlerësimit ndaj asaj të ndërtimit ose të vënies në shfrytëzim). Vlerësimi nga ekspertët bëhet duke përdorur çmimet e tregut.

Dokumentacioni teknik i ekspertëve vlerësues përfshihet në dosjen e vlerësimit.

2. Për ndërtimet në proces, vlera aktuale minimale do të përcaktohet sipas kapitullit të I-rë duke pasur parasysh që:

- Vlera fillestare kontabël llogaritet në bazë të situacioneve të pranura për likuidim nga banka.

- Për ndërtimet në proces, pas 1 korrikut 1992 e në vazhdim, vlera e punimeve për çdo situacion të dorëzuar në bankë do të korrigjohet:

- a) me raportin e indeksit të çmimit të periudhës së vlerësimit ndaj atij të përfundimit të punimeve;

- b) me shtesat ose pakësimet për vendndodhjen.

3. Vlerësimi i makinerive, pajisjeve, bëhet për çdo makineri ose pajisje që përbën njësi inventari të veçantë. Për makineritë dhe pajisjet të vëna në përdorim para vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), si dhe pas vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), VAM-i përcaktohet njëjloj si ndërtimet sipas rasteve përkatëse (kapitulli i I-rë), por pa zbatuar koeficientin e vendndodhjes.

4. Vlerësimi i mjeteve të transportit tokësor e detar, të vëna në përdorim para vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), VAM-i përcaktohet njëjloj si ndërtimet sipas rasteve përkatëse (kapitulli i I-rë), por pa zbatuar koeficientin e vendndodhjes. Për mjetet e transportit të blera ose të vëna në shfrytëzim pas vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), VAM-i përcaktohet njëjloj si për ndërtimet, sipas rasteve përkatëse (kapitulli i I-rë), por pa zbatuar indeksin e çmimit dhe koeficientin e vendndodhjes.

5. Për inventarin ekonomik, instrumentet dhe veglat e punës, si dhe elemente të tjerë që figurojnë në përbërje të aktivëve të qëndrueshëm (mjete kryesore) të ndërmarrjes, vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit në bazë të vlerës kontabël të mbetur. Vlera kontabël e mbetur përcaktohet për çdo njësi inventari, duke zbritur nga vlera fillestare kontabël shumë e amortizimit që i përgjigjet shkallës së konsumit për shkak të përdorimit

6. Për kafshët e punës dhe të përdorimit të prodhimit dhe për gjënë e gjallë në rritje dhe majmëri, vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit në bazë të çmimeve të tregut duke mbajtur parasysh vlerën zooteknike.

7. Për kulturat drufrutore, ullinjë, vreshtat në prodhim ose në rritje, vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit në bazë të llogaritjes së vlerës kontabël të regjistruar dhe duke zbritur, kur është rasti, dëmtimet e pësura.

Për rastet e mungesave ose të dëmtimeve, komisioni a grupi i ekspertëve vlerësues të veprave si për ndërtimet. Për këtë grup vlera e mbetur nuk indekskohet.

8. Vlerësimi i mjeteve të xhiros që janë gjendje në ndërmarrje, bëhet në këtë mënyrë:

Komisioni i vlerësimit i ndan mjetet e xhiros në tre grupe:

- Grupi "a" ku bëjnë pjesë artikujt që kanë vlera tregtimi me qarkullim normal dhe që vlerësohen me vlerën aktuale kontabël duke i krahasuar me çmimet e shitjes me shumicë në tregun aktual.

- Grupi "b" ku bëjnë pjesë artikujt që kanë vlerë tregtimi, por me qarkullim të ngadalshëm, e që vlerësohen me vlerën kontabël të kohës së blerjes së artikullit ose të përgatitjes së produktit të gatshëm për shitje, duke i krahasuar me çmimet e shitjes me shumicë në tregun e sotëm.

- Grupi "c" ku bëjnë pjesë artikujt që nuk gjejnë treg shitjeje dhe nuk kanë vlerë aktuale si materiale, pjesë ndërrimi, që përdoren nga makineri e mjete transporti të hequra nga përdorimi dhe që vlerësohen me vlerën kontabël të kohës kur janë futur gjendje në ndërmarrje, të shumëzuar me koeficientin 0.1.

Kur ka elemente pasurie pa vlerë përdorimi ose të zhvlerësuar, nxirren jashtë përdorimit ose u ulët vlera. Nxjerrja jashtë përdorimit bëhet në përputhje me vendimin nr.170, datë 3.4.1993 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 70, datë 11.3.1985 të Këshillit të Ministrave "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare". Ulja e vlerës bëhet nga komisioni i vlerësimit dhe me pjesëmarrjen e grupit të ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë dhe miratohet nga këshilli drejtues i ndërmarrjes.

Vlera e nxjerrë nga komisioni i vlerësimit ditën e mbylljes së vlerësimit, si pasojë e shumës së tri vlerave të sipërpërmendura, përfaqësojnë vlerën aktuale minimale të mjeteve të xhiros në çastin e shitjes për ndërmarrjet me veprimtari të bllokuar në intervalin e kohës vlerësim-shitje. Për ndërmarrjet që vazhdojnë veprimtaritë gjatë intervalit vlerësim-shitje, blerjet pas vlerësimit të pasqyrohen në kartela të reja, kurse shitjet në kartelat ekzistuese. Në këtë rast i jepet e drejta likuidatorit, që për artikujt e rinj të grupit "a", me një grup ekspertësh, të bëjë vlerësimin e tyre sipas çmimeve aktuale të tregut me shumicë. Për të tjerët qëndron në fuqi mënyra e sipërpërmendur e vlerësimit.

9. Indeksi i çmimeve, i publikuar nga INSTAT-i, do të zbatohet për muajin e përcjelljes së dokumentacionit të vlerësimit në degën e shoqërive publike.

10. Koeficienti i vendndodhjes, i cili përdoret vetëm për ndërtimet dhe objektet ndërtimore, duhet të konfirmohet nga zyra e urbanistikës në organet e qeverisjes vendore ku ndodhet objekti. Tabelat e përcaktimit të këtij koeficienti i bashkëlidhen këtij vendimi.

11. Vlerësimi i detyrimeve të ndihmave shtetërore që krijojnë fond kundërparti, bëhet sipas kritereve të vendimeve nr.47, datë 7.2.1994 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet ose vendoset në shoqëritë e përbashkëta, si dhe përcaktimi i qirasë për objektet shtetërore, që u jepen në përdorim të tretëve", i ndryshuar dhe nr.55, datë 30.1.1995 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në vendimin nr.465, datë 3.10.1994 të Këshillit të Ministrave", si dhe të udhëzimit të Ministrisë së Financave në zbatim të tyre. Këto do të pasqyrohen si zë më vete, pasi pagesa e tyre do të bëhet në lekë.

12. Për vlerësimin e asetëve në shoqëritë tregtare, si vlerë fillestare kontabël do të jetë vlera e regjistruar në aktin e vlerësimit të kapitalit të shoqërisë, në çastin e themelimit.

13. Dokumentacioni për vlerësimin e pronës shtetërore që privatizohet, përgatitet sipas pasqyrave, që i bashkëngjiten këtij vendimi.

II. DETYRIMET DEBITORE DHE KREDITORE

Detyrimet debitore dhe kreditore të ndërmarrjeve shtetërore që privatizohen mbyllen në çastin e ndryshimit të pronësisë. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore mban përgjegjësi për rritjen e debi-kredive nga dita e shpalljes së ndryshimit të pronës shtetërore. Për detyrimet debitore dhe kreditore veprohet si më poshtë vijon:

1. Kur bëhet privatizimi i gjithë ndërmarrjes shtetërore, detyrimet debitore dhe kreditore i kalojnë shtetit. Organi qendror ose pushteti vendor, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes, ngarkojnë një punonjës të sistemit financiar ose një profesionist të lirë, me një kontratë të posaçme për ndjekjen e arkëtimit, deri në 30 ditë nga data e dorëzimit të objektit. Këta kanë të drejtën e shpërblimit nga 5 deri në 10 për qind të shumave të arkëtuara, por jo më shumë se 12 paga bazë të përgjegjësit të financës në këshillin e qarkut ose të bashkisë. Organi i varësisë administrative parashikon në buxhetin e vitit pasardhës fondin e pagës për punonjësin e ngarkuar. Ky shpërblim ulët deri në zero, në qoftë se nuk zbatohet kontrata. Kjo kontratë është e vlefshme deri në 3 muaj dhe pas kësaj veprohet në bazë të ligjit nr.8901, datë 23.5.2003 "Për falimentimin".

2. Kur bëhet privatizimi i pjesshëm i ndërmarrjes shtetërore, detyrimet debitore dhe kreditore të ndërmarrjes për pjesën që mbetet shtetërore i kalojnë për ndjekje administratës.

3. Likuidimi i detyrimeve të mbetura, për fondin kundërparti të ndihmave shtetërore bëhet sipas kritereve të vendimeve nr.465, datë 3.10.1994, nr.55, datë 30.1.1995 të Këshillit të Ministrave,

si dhe të udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tyre.

III. PROCEDURA E SHITJES SË PRONËS SHETËTËRORE

1. Në këtë vendim, pronë shetëtorë konsiderohet çdo njësi prodhimi, shërbimi, pjesë të tyre, mjete lundrimi e mjete xhiroje, që janë vendosur të shiten si pasuri fizike, sipas përcaktimit në miratimin e privatizimit.

2. Privatizimi i këtyre objekteve do të bëhet nëpërmjet ankandit.

- Ish-pronarët e truallit, në zbatim të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", kanë të drejtën e parablerjes së objektit me vlerë fillestare. Në rastet kur nuk ka pronar truallit ose nuk janë paraqitur dokumentet e pronësisë deri në datën e zhvillimit të ankandit, objekti i nënshtrohet ankandit. Vlera e truallit i kompensohet pronarit sipas dispozitave në fuqi.

3. Për punonjësit që i kanë pasur dhe i kanë në përdorim automjetet, makineritë, pajisjet dhe mjetet e punës, të cilat janë të panevojshme për zhvillimin e veprimtarisë dhe propozohen të shiten të shkëputura nga objektet, kryhet shitja pa ankand.

Miratimi për t'ia shitur atë përdoruesit bëhet nga organi që ka në varësi administrative ndërmarrjen. Në rast se punonjësit që i kanë pasur ose i kanë në përdorim, nuk paraqesin kërkesë për blerjen e tyre, si dhe vërtetimin se janë përdorues të automjetit, makinerisë, pajisjes dhe mjetit të punës, brenda afatit të publikuar, objektet kalojnë në ankand.

4. Për objektet e shërbimit stomatologjik dhe farmaceutik, punonjësit specialistë që kanë sot për sot kontratë qiraje për objektin, kanë të drejtën e parablerjes, sipas çmimit të përcaktuar në ankand, nëse këto objekte dhe truallin nën objekt nuk kanë pronarë truallit. Destinacioni i këtyre objekteve të mos ndryshojë për pesë vjet.

5. Procedurat e publikimit fillojnë pasi të jenë dorëzuar në AKP ose në degën e AKP-së dokumentet e vlerësimit të objektit. AKP-ja ose dega e AKP-së e pranon dosjen e objektit, nëse ekziston dokumentacioni i rregullt dhe ka kaluar në strukturat përkatëse të përcaktuara në këtë vendim. Në të kundërt kërkohet plotësimi i dokumentacionit. Vlera e fillimit të ankandit do të jetë VAM-i i përcaktuar sipas kapitullit të I-rë të këtij vendimi (mjete kryesore+mjete xhiroje). Ankandi të zhvillohet vetëm për mjetet kryesore dhe vlera e mjeteve të xhiros të shtohet sipas inventarit fizik në momentin e dorëzimit të objektit.

Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj me të pranuar dokumentet e vlerësimit të objektit, fillojnë botimin për privatizim, pas zbatimit të pikës 3 të kapitullit III të këtij vendimi si më poshtë vijon:

- a) publikohet një njoftim në tri gazeta me qarkullim kombëtar, katër herë gjithsej;
- b) publikohet lista e objekteve që do të privatizohen dhe të dhënat për këtë objekt në faqen e internetit të AKP-së;
- c) periudha e publikimit duhet të jetë 21 ditë nga njoftimi i parë;
- ç) në fillimin e publikimit AKP-ja dhe degët e saj duhet të vendosin njoftimin me afishe në mjediset e tyre dhe në ndërmarrjet përkatëse për objektet që do të privatizohen.

Njoftimi për publikim duhet të përcaktojë të dhënat e mëposhtme:

- vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;
- emërtimin dhe vendndodhjen e objektit që do të privatizohet;
- vlefthën fillestare të fillimit të ankandit;
- sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nën objekt;
- të dhëna për veprimtarinë e kryer dhe të dhëna sqaruese për objektin.

Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës së tyre në AKP, kanë të drejtë të studiojnë dokumentacionin e vlerësimit që ndodhet i depozituar në AKP dhe të njihen me gjendjen fizike të objektit.

6. Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj hartojnë dhe arkivojnë një procesverbal që përmban: emrin e gazetës, datat kur janë botuar njoftimet, si dhe një kopje të njoftimit me afishe.

7. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit këtë dokumentacion:

- kërkesë me shkrim për blerjen e objektit;
- mandatin ose garancinë bankare që vërteton pagesën 20 për qind të vlefthës së fillimit të ankandit në lekë, e cila paguhet në llogarinë përkatëse të AKP-së, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

8. Ish-pronari i truallit, bashkëngjitur kërkesës për blerjen e ndërmarrjes ose objektit, që

shtrihet mbi tokën ish-pronë e tij, duhet të paraqesë në AKP ose në degën e saj, përveç sa kërkohet në pikën 6, edhe vendimin përkatës të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, që përcakton se ai është ish-pronar i tokës. Kur sipërfaqja e tokës ish-pronë private shtrihet mbi 80 për qind të të gjithë tokës nën objekt, e drejta e parablerjes shtrihet në gjithë objektin. Kjo vlen edhe për rastet edhe kur ka disa bashkëpronarë dhe ndërmjet tyre ka një marrëveshje të dokumentuar. Në rastet kur objektit i është ulur vlera e fillimit të ankandit (meqë nuk është shitur me çmim fillestar të publikuar), ish-pronari, për të gëzuar të drejtën e parablerjes, duhet të bëjë pagesën e plotë sipas vlefës fillestare dhe jo sipas vlefës së ulur.

9. Kur për objektet e shpallura për shitje sipas procedurave të këtij vendimi nuk paraqitet asnjë kërkesë për blerjen e tyre, atëherë Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj caktojnë një VAM tjetër më të ulët për të tërhequr kandidatët për privatizimin e objektit. Ulja e VAM-it të objekteve bëhet sipas këtij kategorizimi:

- a) për ndërmarrjet ose objektet ulja e VAM-it të jetë deri 30 për qind;
- b) për makineritë, pajisjet, inventarin ekonomik, mjetet e transportit, mjetet e xhiros ulja e VAM-it të jetë deri 50 për qind.

Në këto raste objekti kalon edhe një herë në të gjitha procedurat e këtij vendimi. Për rastet kur mbetet vetëm një blerës si në publikimin me vlerë fillestare, ashtu edhe për rastin kur objekti është i publikuar me ulje VAM-i, bëhet një njoftim i ri në një gazetë kombëtare, për një periudhë 10 ditore nga ky njoftim, si dhe vendoset një njoftim me afishe pranë mjediseve të AKP-së ose degëve të saj. Pas këtij publikimi Agjencia Kombëtare e Privatizimit ose degët e saj në prefektura bëjnë shitjen e objektit.

10. Për objektet që mbeten pa u shitur, edhe pasi është vepruar sipas pikës 9 të këtij vendimi, do të kalohet në shitjen me rezervë nëpërmjet shitjes me këste, me afat kohor deri 5 vjet për objektet dhe deri 2 vjet për makineritë, pajisjet dhe mjetet e transportit etj. Vlera e shitjes në këto raste është ajo e VAM-it fillestar. Shitja me rezervë të bëhet me ankand të hapur. Kriteri bazë për fituesit e ankandit të jetë shlyerja e çmimit të shitjes, në afatin më të shkurtër kohor. Në rastet kur blerësit ofrojnë afate kohore të njëjta, komisioni i ankandit fikson këtë afat shlyerje të vlerës së objektit dhe kalon në zhvillimin e ankandit mbi vlerën e publikuar të objektit.

Përcaktimi i kësteve dhe vlerat përkatëse të çdo kësti të parashikohen në kontratën e shitjes nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Ish-pronarët e truallit gëzojnë të drejtën e parablerjes sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij kapitulli, por gjithmonë sipas vlerës fillestare të objektit dhe me afat shlyerje 30 ditë.

11. Procedurat e publikimit për shitjen me rezervë fillojnë nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit menjëherë pas përfundimit të ankandit, të kryer sipas pikës 9 të këtij kapitulli. Publikimi të bëhet sipas pikës 5 të këtij kapitulli dhe me të njëjtat të dhëna, duke shtuar formën e shitjes me rezervë.

12. Në rastet kur edhe pas zbatimit të shitjes me rezervë nuk do të paraqitet asnjë blerës, të zhvillohet një ankand tjetër, pa përcaktimin e vlerës së objektit. Ankandi të bëhet me zarfa të mbyllur. Kalimi për shitje sipas këtij ankandi bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKP-së brenda 20 ditësh nga data e zhvillimit të ankandit për shitjen me rezervë të objektit. Blerësit, për pjesëmarrje në këtë ankand, krahas kërkesës duhet të paraqesin pagesën të përgjithshme të çmimit të ofruar për blerjen e objektit. Fitues ankandi shpallet personi që paraqet vlerën më të lartë. Në rast të vlerave të barabarta atëherë për përcaktimin e fituesit, zhvillohet ankandi ndërmjet tyre, mbi vlerën e ofruar. Pagesa në këtë ankand do të jetë me një këst.

Procedurat e publikimit për këtë lloj ankandi të bëhen sipas pikës 5 të këtij kapitulli duke përcaktuar formën e shitjes pa vlerën e objektit.

Ish-pronarët e truallit gëzojnë të drejtën e parablerjes sipas pikës 2 të këtij kapitulli, por me vlerë fillestare të objektit dhe me afat shlyerje 30 ditë nga data e zhvillimit të ankandit.

13. Procedurat për rastet e parashikuara në pikat 9, 10, 11, 12 të fillojnë me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit. Çdo rregull shtesë do të jetë pjesë e publikimit.

14. Përbërja e komisionit të ankandit

- a) Kur ankandi zhvillohet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit komisioni të përbëhet nga:
 - Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.....kryetar
 - Përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë..... anëtar

- Përfaqësuesi i organit që ka në administrim objektin..... anëtar
- Juristi i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit pa të drejtë vote.....anëtar
- b) Kur ankandi zhvillohet në degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit komisioni përbëhet

nga:

- Përfaqësuesi i degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.....kryetar
- Përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë (dega e shoqërive publike).....anëtar
- Përfaqësuesi i organit që ka në administrim objektin.....anëtar

Anëtarët e komisionit të ankandit duhet të pajisen me autorizimin përkatës dhe pjesëmarrja e tyre në datën e orën e caktuar për ankand është e detyrueshme.

Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- Të regjistrojë dhe vërtetojë identitetin e pjesëmarrësve në ankand sipas letërnjoftimit a certifikatës së gjendjes civile ose me prokurë të veçantë përfaqësimi.
- Të prezantojë anëtarët e komisionit të ankandit.
- Të deklarojë vlefshëm fillestare të ankandit.
- Të deklarojë hapin e dhënies të ofertave mbi vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand.
- Të drejtojë marrjen e ofertave.
- c) Të shpallë personin e fundit që deklaron çmimin më të lartë si fitues i ankandit.
- Të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera përpara shpalljes së fituesit.

Procesverbali i ankandit është i detyrueshëm për t'u nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe pjesëmarrësit në ankand.

15. Pjesëmarrësve të tjerë në ankand (përveç fituesit), iu kthehet 20 për qind e vlefshëm fillestare të paguar paraprakisht. Kërkesit për blerje të objektit, i cili nuk merr pjesë në ankand ose që tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë mbi vlerën e objektit të shpallur për shitje i mbahet 100 për qind e vlerës së 20 për qindëshit të arkëtuar për pjesëmarrje në ankand.

16. Personi që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nëpërmjet ankandit ose me të drejtën e parablerjes nga ana e AKP-së ose dega e saj, pajiset me autorizimin për kalim pronësie. Në këtë autorizim duhet të jenë përcaktuar qartë detyrimet e blerësit.

17. Brenda 30 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, blerësi është i detyruar të bëjë pagesën në lekë të pjesës së mbetur të çmimit të arritur në ankand, kur 20 për qind e vlerës së objektit është paguar në lekë. Nga pagesa 20 për qind e vlerës fillestare të objektit të paguar në lekë, zbritet shuma e llogaritur, në masën 5 për qind të vlerës fillestare të objektit, e cila mbahet si e ardhur për AKP-në.

18. Nëse personi që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nuk paguan brenda 30 ditëve pjesën e mbetur të çmimit të arritur në ankand nga dita e paraqitjes si pronar toke ose fitues ankandi, ai e humbet të drejtën e blerjes. Pagesa prej 20 për qind e arkëtuar për pjesëmarrje në ankand nuk i kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit nga e para sipas këtij vendimi.

19. Pas pagesës të vlefshëm të plotë të objektit, AKP-ja dhe degët e saj në prefektura janë të detyruara, të lidhin kontratën e shitjes nga pala shitëse (përfaqësuesi i AKP-së, drejtori i ndërmarrjes për dorëzimin e pronës, blerësi privat). Afati i lidhjes së kontratës duhet të jetë jo më shumë se 60 ditë nga data e kryerjes së pagesës. Nënshkrimi i kontratës dhe dorëzimi i objektit nga përfaqësuesit e shtetit, përfaqësuesi i AKP-së dhe drejtori i ndërmarrjes, është i detyrueshëm. Marrja në dorëzim e ndërmarrjes ose objektit nga blerësi bëhet sipas procedurave të këtij vendimi.

20. Nuk lejohet dhënia me qira dhe kalimi kapital i objekteve që janë publikuar për shitje.

21. Për objektet që nuk janë shitur edhe pasi është zbatuar pika 11 e kapitullit III të këtij vendimi, veprohet sipas vendimit nr.197, datë 20.3.1998 të Këshillit të Ministrave "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve që nuk ka qenë e mundur të shiten".

22. Për shitjet e bëra nga AKP-ja dhe degët e saj njoftohet Ministria e Ekonomisë në datën 20 të çdo muaji, me një evidencë statistikore. Agjencia Kombëtare e Privatizimit duhet të dërgojë në Ministrinë e Ekonomisë autorizimet e kalimit të pronësisë për shitjet e kryera.

IV. DETYRAT DHE TË DREJTAT PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI

1. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore miratohet nga drejtuesi i institucionit ose i ndërmarrjes, ku kryhet vlerësimi i pasurisë shtetërore. Komisioni të ketë jo më pak se tre anëtarë, ku të bëjë pjesë detyrimisht kryetari i degës së financës ose përgjegjësi i llogarisë së ndërmarrjes dhe të kryesohet nga drejtori a zëvendësi i tij.

2. Komisionit i vlerësimit, për rastet e përcaktuara në këtë vendim, kërkon miratimin ekspertëve vlerësues. Këta ekspertë, sipas kërkesës së ndërmarrjes a të institucionit, miratohen nga titullari i organit administrativ ose pushtetit lokal, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes. Numri i ekspertëve duhet të jetë jo më pak se dy dhe ata duhet të jenë specialistë të fushës përkatëse të vlerësimit që do të kryejnë. Komisioni i vlerësimit dhe ekspertët përkatës vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë e vlerësimit të kryer.

3. Anëtarët e komisionit, për periudhën e vlerësimit të pronës shtetërore, përfitojnë një pagesë suplementare mbi pagën bazë. Shpenzimet për këto pagesa kryhen dhe evidencohen nga ndërmarrja ose institucioni që kryen vlerësimin e pasurisë. Masa e shpërblimit mbi pagën bazë të anëtarëve të komisionit të vlerësimit të pasurisë shtetërore të jetë:

a) Anëtarët e komisionit që janë punonjës të ndërmarrjes ose institucionit, përfitojnë një shtesë 30 për qind mbi pagën bazë që kanë pasur. Këtë masë shpërblimi e përfiton edhe drejtori i ndërmarrjes a institucionit, pavarësisht nëse është anëtar i këtij komisioni.

b) Ekspertët vlerësues të pasurisë shtetërore përfitojnë një shtesë 50 për qind mbi pagën bazë, për ditët e pjesëmarrjes në vlerësim. Kur ekspertët janë profesionistë të lirë, pagesa e tyre është 1000 (një mijë) lekë në ditë. Ditët e punës të nevojshme për ekspertim përcaktohen nga drejtuesi i ndërmarrjes ose institucionit.

4. Afati i plotësimit të dokumentacionit të vlerësimit për ndërtesat dhe ndërtimet, linjat e prodhimit dhe të shërbimit duhet të jetë jo më shumë se 40 ditë nga data e mbërritjes në ndërmarrje ose institucion, miratimi i privatizimit, ndërsa për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit etj., afati duhet të jetë jo më shumë se 20 ditë. Ky afat të përcaktohet, për çdo rast konkret, në urdhrin për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe përfundimi i tij të jetë deri në datën e dërgimit të dokumentacionit të vlerësimit të pasurisë nga ndërmarrja ose institucioni në degën e shoqërisë publike përkatëse. Respektimi i këtij afati kontrollohet nga organi përkatës i varësisë administrative.

5. Dokumentacioni i përgatitur nga komisioni i vlerësimit, dërgohet për kontroll në degën e shoqërive publike përkatëse. Pasi kontrollohet nga dega e shoqërisë publike, kur ky dokumentacion gjendet i rregullt, në përputhje me legjislacionin e privatizimit, i përcillet brenda 20 ditëve:

a) organit të varësisë administrative, për objektet ndërtimore dhe linjat e prodhimit ose të shërbimit;

b) degës përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, inventarin ekonomik, mjetet e xhiros etj.

6. Dokumentacioni i kontrolluar nga organi i varësisë administrative, pas kontrollit të ushtruar, kur gjendet i rregullt, përcillet në organin që mban tagret e përfaqësuesit të pronës shtetërore, brenda 15 ditëve.

7. Dokumentacioni i kontrolluar nga përfaqësuesi i pronës shtetërore, kur gjendet në përputhje me legjislacionin e privatizimit, përcillet në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

Dega e shoqërive publike në prefekturë bën verifikimin e pronës që privatizohet duke mbajtur një procesverbal verifikimi në prani të drejtorit të ndërmarrjes dhe të të ngarkuarit të AKP-së. Në procesverbalin e verifikimit të pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve që privatizohen, duhet të pasqyrohen të dhëna që lidhen me gjendjen fizike të objektit, nëse objekti është i lirë ose i zënë forcërisht, nëse për objektin ka kontratë qiraje dhe nëse ka probleme me genplanin ose planimetrinë e tij. Në rastin e paraqitjes së problemeve dega e shoqërisë publike kërkon ndërhyrjen e organit të varësisë administrative.

8. Përfaqësuesi i AKP-së dhe drejtori i ndërmarrjes janë të detyruar të përfundojnë dorëzimin me procesverbal të objektit që privatizohet brenda 35 ditëve nga data e dhënies së autorizimit blerësit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Drejtori i ndërmarrjes është përgjegjës për dorëzimin e pronës së blerësit.

Për diferencat fizike të lindura ndërmjet periudhës së vlerësimit dhe dorëzimit të objektit ose ndërmarrjes mbahet një procesverbal në prani të drejtorit të ndërmarrjes, ku evidencohen diferencat fizike dhe arsyet e krijimit, nxirren përgjegjësitë, kërkohet zhdëmtimi i tyre dhe bëhet kallëzimi në organet e drejtësisë për diferencat e papërligjura.

Procesverbali i dorëzimit nënshkruhet nga përfaqësuesi i AKP-së, drejtori i ndërmarrjes dhe nga fituesi i së drejtës së blerjes së objektit dhe shërben si aktdorëzimi i pasurisë. Pas pagesës së plotë të vlerës së objektit, lidhet kontrata e shitjes, e cila nënshkruhet nga përfaqësuesi i AKP-së për dorëzimin e pronës, drejtori i ndërmarrjes dhe fituesi i së drejtës së blerjes.

Për rastet kur ka vështirësi në dorëzimin e objekteve, afati 35-ditor i dorëzimit zgjatet me autorizim të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

9. Procesverbali i nënshkruar dorëzohet brenda afatit 35-ditor pranë degës së AKP-së së prefekturës përkatëse. AKP-ja i kthen vlerën e munguar blerësit duke u bazuar në diferencat e përlligjura të evidencuara me procesverbalet përkatëse.

Përfaqësuesi i AKP-së dhe drejtori i ndërmarrjes që privatizohet, kanë të drejtë të marrin specialistë ekspertë për dorëzimin e pronës shtetërore, kur ndërmarrja e ka vazhduar veprimtarinë dhe kur vërehen mungesa fizike në njësitë e inventarit. Gjatë procesit të dorëzimit çdo blerës ka të drejtë të marrë pjesë ose të autorizojë një përfaqësues të tij.

Kur blerësi e ka fituar të drejtën e blerjes së pronës shtetërore nëpërmjet ankandit dhe ka diferenca (mungesa) në dorëzimin e objektit, vlera e kthimit të diferencave do të jetë vlera e mungesave fizike, të rezultuara sipas VAM-it, shumëzuar me masën e rritjes së vlerës së ankandit në krahasim me vlerën fillestare të ankandit për objektin e shitur. Blerësit i kthehet kjo vlerë me urdhër të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

10. Vendimi nr.192, datë 20.3.1998 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes”, me ndryshimet përkatëse si dhe udhëzimet në zbatim të tyre, shfuqizohen.

11. Në zbatim të këtij vendimi nuk do të përfshihen:

a) Procedurat e vlerësimit për dokumentacionin e objekteve që janë dërguar në organet e varësisë administrative dhe në Ministrinë e Ekonomisë, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa për procedurat e shitjes do të zbatohet ky vendim.

b) Praktikën, për të cilat kanë filluar procedurat e publikimit nga AKP-ja deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit të hartojnë udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M **Nr.166, datë 13.3.2003**

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.506, DATË 21.9.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I KRYQËZIMIT NË ZONËN E PLEPAVE, DURRËS, PJESE E SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-RROGOZHINË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.506, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 3, të shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 7005 m2 tokë/truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 56 187 105 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesë) lekësh.”.

b) Pas pikës 4, të shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Fondi prej 56 187 105 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesë) lekësh, si dhe shpenzimet procedurale prej 319 200 (treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e

dyqind) lekësh, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

c) Pas pikës 5, shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.4.2003.”.

2. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.

3. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QARKU DURRËS

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-RROGOZHINË (VIADUKATI PLEPA)**

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Truall		Vlera lekë	Shënime
				Sip.m2	Çmimi Lekë/m2		
1	Robert	Kozma	Kote	2700	8021	21656700	Konflikt gjyqësor
2	Xhevahire	Osman	Marku	1615	8021	12953915	
3	Rudin	Sofokli	Mukja	502	8021	4026542	
4	Haxhi	Xhelal	Nezha	495	8021	3970395	
5	Jakup		Ismaili	98.6	8021	790870.6	
	Arben		Ismaili	98.6	8021	790870.6	
	Shehri		Ismaili	98.6	8021	790870.6	
	Sefer		Ismaili	98.6	8021	790870.6	
	Bashkim		Ismaili	98.6	8021	790870.6	
6	Trashëgimtarët e Jakup Troplinit			1200	8021	9625200	
		Totali		7005	8021	56187105	

Shuma totale e shpronësimit 56187105 lekë Shpenzime procedurale 319200 lekë

V E N D I M

Nr.169, datë 13.3.2003

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË SHITJES SË TROJEVE TË
NDËRMARJEVE SHETËTËRORE QË I NËNSHTROHEN PRIVATIZIMIT OSE
TRANSFORMIMIT TË TYRE NË SHOQËRI TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991
”Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të
pavarura dhe privatizimit”, me propozim të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli Ministrave

V E N D O S I:

I. PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E TRUALLIT

1. Ky vendim ka për objekt të përcaktojë kriteret dhe procedurat për vlerësimin dhe shitjen e truallit të ndërmarrjeve shtetërore që i nënshtrohen procedurave të privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen”, si dhe të vendimit nr. 194, datë 20.3.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve në shoqëri tregtare”.

2. Procedurat e vlerësimit të truallit të fillojnë me daljen e urdhrit të përfaqësuesit të pronarit shtetëror:

a) për privatizimin e ndërmarrjes ose objekteve të saj në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, si dhe procedura e shitjes”;

b) për transformimin e ndërmarrjes shtetërore në shoqëri tregtare, në zbatim të vendimit nr. 194, datë 20.3.1998 të Këshillit të Ministrave.

II. PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË TRUALLIT TË NDËRMARRJEVE QË PRIVATIZOHEN OSE TRANSFORMOHEN NË SHOQËRI TREGTARE

1. Me marrjen e urdhrit të përfaqësuesit të pronarit shtetëror, ndërmarrja krijon komisionin e vlerësimit, i cili brenda 15 ditëve përgatit:

a) genplanin e ndërmarrjes ose objekteve të saj, në zbatim të urdhrit të përfaqësuesit të pronarit, në pesë ekzemplarë origjinalë;

b) përshkrimin e ndërmarrjes dhe /ose objekteve të saj sipas genplanit;

c) përcaktimin e sipërfaqes së nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së tyre, ku të saktësohen sipërfaqet nën objekt dhe funksionale.

2. Drejtoria e ndërmarrjes menjëherë pas marrjes së dokumentacionit të mësipërm nga komisioni i vlerësimit, shoqëruar me urdhrin përkatës të përfaqësuesit të pronarit shtetëror, i drejton organit të qeverisjes vendore në varësi të vendndodhjes së objektit kërkesën:

a) për miratimin e genplanit me sipërfaqen përkatëse nga zyra e urbanistikës;

b) për caktimin e vlerës së truallit, nga seksioni i financës.

3. Zyra e urbanistikës së organit të qeverisjes vendore, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës së ndërmarrjes, i kërkon zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, informacion zyrtar për statusin e pronësisë së trojeve a objekteve të paluajtshme, që përfshihen në genplanin e hartuar nga ndërmarrja, hartën treguese të këtyre pasurive të paluajtshme dhe vlerën mesatare të shitjes së truallit për m2, sipas shitjeve të regjistruara në zonën përkatëse brenda një viti nga data e kërkesës së ndërmarrjes.

4. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës i dërgon :

a) Zyrës së urbanistikës së organit përkatës të qeverisjes vendore, hartën treguese të pasurive të paluajtshme në zonën përkatëse, sipas kërkesës. Në rastet kur rezulton që pasuria e paluajtshme, pronë shtetërore ose pjesë të saj janë regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, njofton zyrtarisht zyrën e urbanistikës dhe përfaqësuesin e pronarit shtet se mbi ç’bazë dokumentare është kryer regjistrimi, si dhe për institucionin që ka lëshuar dokumentacionin e pronësisë. Konflikti zgjidhet në rrugë ligjore para kryerjes se procedurave të vlerësimit;

b) Seksionit të financës së organit të qeverisjes vendore, vlerën mesatare të shitjes së truallit për m2, sipas kërkesës.

5. Zyra e urbanistikës e organit përkatës të qeverisjes vendore brenda 10 ditëve, pas marrjes së përgjigjes prej zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, saktëson genplanin përfundimtar në pesë ekzemplarë origjinalë, dërguar nga ndërmarrja në bazë të dokumentacionit të siguruar si më sipër, në të cilin saktësohet sipërfaqja nën objekt, sipërfaqja funksionale dhe e përgjithshme. Genplani i hartuar në pesë ekzemplarë origjinalë i përcillet seksionit të financës së organit përkatës të qeverisjes vendore.

6. Seksioni i financës, brenda 5 ditëve nga marrja e dokumentacionit prej zyrës së urbanistikës dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përcakton vlerën e truallit dhe dokumentacionin ia përcjell ndërmarrjes, në pesë ekzemplarë origjinalë të firmosur dhe të vulosur:

a) genplanin përfundimtar të konfirmuar nga zyra e urbanistikës;

b) aktin e vlerësimit të truallit;

c) hartën treguese.

7. Kur zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme nuk zotëron të dhënat për vlerën mesatare të shitjes së truallit për m2, seksioni i financës pranë organeve përkatëse të qeverisjes vendore, në zbatim të vendimit nr.394, datë 27.5.1996 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e licencave profesionale për vlerësimin e pasurive të paluajtshme” ngre menjëherë komisionin e vlerësimit të truallit. Komisioni i vlerësimit të truallit do të përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët: një urbanist, një jurist, një ekonomist, një topograf dhe kryetar do të jetë nënkryetari i organit të qeverisjes vendore. Ky komision brenda 20 ditëve duhet të përcaktojë vlerën mesatare të shitjes së truallit për m2, bazuar në sondazhe mbi kërkesë-ofertën e tregut për shitblerjen e trojeve në zonën përkatëse.

8. Ndërmarrja pas marrjes së dokumentacionit nga seksioni i financës së organit të qeverisjes vendore, vazhdon procedurat përkatëse sipas urdhrit të përfaqësuesit të pronarit shtetëror.

III. PROCEDURAT E SHITJES SË TRUALLIT TË NDËRMARRJEVE QË NUK MUND TË TRANSFORMOHEN NË SHOQËRI TREGTARE

1. Shitja e truallit të ndërmarrjeve ose objekteve që do të privatizohen, bëhet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe, sipas përcaktimit në autorizimin e kalimit të pronësisë të lëshuar për këtë qëllim, për ndërmarrjen ose objektin përkatës.

2. Sipërfaqja e domosdoshme për zhvillimin e veprimtarisë së ndërmarrjes ose pjesëve të ndara të saj përcaktohet mbi bazën e genplanit ekzistues të ndërmarrjes duke hequr nga kjo sipërfaqe pjesë të panevojshme për funksionimin e ndërmarrjes ose të objektit. Kjo sipërfaqe përcaktohet nga komisioni i vlerësimit në ndërmarrje, saktësohet dhe konfirmohet nga zyra e urbanistikës dhe ajo e financës të organit përkatës të qeverisjes vendore. Kjo sipërfaqe miratohet nga drejtoria e shoqërive publike pranë prefekturës. Këto organe mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë e sipërfaqes.

3. Shitja e truallit është pjesë e kontratës së shitjes të ndërmarrjes ose objektit. Paga e truallit bëhet vetëm me lekë sipas vlerës së përcaktuar në dosjen e privatizimit të ndërmarrjes ose objektit.

4. Në rast se pronari i ri i ndërmarrjes ose objektit të privatizuar nuk dëshiron të blejë truallin përkatës, atëherë atij nuk i dorëzohet ndërmarrja/objekti, nëse nuk nënshkruan kontratë vjetore të qirasë së truallit me seksionin e financës së organeve të qeverisjes vendore, e cila është me një çmim vjetor sa 1/10 e vlerës së truallit të përcaktuar në aktin e vlerësimit të truallit, dhe është pjesë përbërëse e dokumentacionit të privatizimit të objektit ose të ndërmarrjes.

IV. PROCEDURAT E SHITJES SË TRUALLIT TË NDËRMARRJEVE DHE OBJEKTEVE QË JANË PRIVATIZUAR

1. Shitja e truallit të pashitur ndërmarrjeve dhe objekteve të privatizuara nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, si dhe nga ish- Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të NB-ve me degët e tyre në rrethe, të bëhet në përputhje me këtë vendim, sipas genplanit të dosjes së privatizimit. Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe, të bëjnë edhe shitjen e trojeve të ndërmarrjeve e objekteve të tjera shtetërore të privatizuara, para krijimit të këtyre agjencive.

2. Personi fizik ose juridik privat, i cili dëshiron të blejë truallin e ndërmarrjes ose të objekteve, që ka privatizuar më parë, të paraqesë në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit në dy kopje këto dokumente:

a) Kërkesën me shkrim për blerje të truallit.

b) Vërtetimin e hipotekës për objektin që ka në pronësi, të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme jo më parë se 10 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, nga e cila një kopje në origjinal, si dhe hartën treguese të pasurive të paluajtshme në zonën përkatëse.

c) Fotokopjen e noterizuar të kontratës së shitblerjes së objektit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të NB-ve dhe degët e tyre në rrethe.

ç) Fotokopjen e noterizuar të kontratës së shitblerjes së objektit për rastet kur privatizimi është bërë para krijimit të këtyre agjencive;

d) Deklaratën materiale origjinale, që nuk ka proces gjyqësor për objektin dhe truallin përkatës.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit brenda 7 ditëve nga paraqitja e kërkesës së mësipërme u dërgon organeve përkatëse të qeverisjes vendore dokumentacionin sipas pikës 2, kapitulli IV, shoqëruar me genplanin përkatës, sipas dosjes së privatizimit, duke kërkuar:

a) aktin e vlerësimit të truallit të objektit dhe vërtetimin se subjekti kërkues ka paguar qiranë e truallit deri në çastin e vlerësimit të tij nga seksioni i financës;

b) miratimin e këtij genplani me sipërfaqet përkatëse nga zyra e urbanistikës.

4. Zyra e urbanistikës së organit të qeverisjes vendore, brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, i kërkon zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, hartën treguese përkatëse të pasurive të paluajtshme dhe vlerën mesatare të shitjes së truallit për m2, sipas shitjeve të regjistruara në zonën përkatëse, brenda një viti nga data e kërkesës së AKP-së.

5. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda 20 ditëve nga marrja e kërkesës i dërgon:

a) zyrës së urbanistikës të organit përkatës të qeverisjes vendore, hartën treguese të pasurive të paluajtshme;

b) seksionit të financës të organit përkatës të qeverisjes vendore, vlerën mesatare të shitjes për m2 të truallit.

6. Zyra e urbanistikës së organit përkatës të qeverisjes vendore brenda 7 ditëve, pas marrjes së përgjigjes nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, saktëson genplanin përfundimtar të dërguar nga AKP-ja në bazë të dokumentacionit të siguruar si më sipër, në të cilin saktësohen sipërfaqja nën objekt, sipërfaqja funksionale dhe ajo e përgjithshme. Ky genplan i përcillet seksionit të financës së organit përkatës të qeverisjes vendore.

7. Seksioni i financës brenda 5 ditëve, nga marrja e dokumentacionit prej zyrës së urbanistikës dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përcakton vlerën e truallit dhe i përcjell AKP-së, të firmosur dhe të vulosur, dokumentacionin i cili përmban:

a) genplanin përfundimtar të konfirmuar nga zyra e urbanistikës;

b) aktin e vlerësimit të truallit;

c) hartën treguese.

8. Kur zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme nuk zotëron të dhënat përkatëse për vlerën mesatare të shitjes së truallit për m2, seksioni i financës së organeve përkatëse të qeverisjes vendore, vepron sipas pikës 8, kapitulli II, të këtij vendimi.

9. Agjencia Kombëtare e Privatizimit pas marrjes së dokumentacionit të nevojshëm nga seksioni i financës së organeve të qeverisjes vendore, njofton kërkuar për t'u paraqitur pranë këtij institucioni për të marrë autorizimin mbi pagesën e vlerës së truallit, pagesë e cila duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit. Pas kryerjes së pagesës së vlerës së truallit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lidh kontratën e shitjes së truallit me blerësin.

10. Pagesa e truallit të ndërmarrjes ose objektit që është privatizuar ose do të privatizohet bëhet vetëm me lekë. Shpërndarja e të ardhurave nga shitja e trojeve bëhet në përputhje me vendimin nr.243, datë 28.5.1999 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në vendimin nr.201, datë 26.3.1998 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e përdorimit të të ardhurave nga shitja dhe qiraja e truallit".

V. TË PËRGJITHSHME

1. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit, prefekturat e qarkut, organet e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

3. Ky vendim nuk do të zbatohet për procedurat e vlerësimit të truallit të objekteve, dokumentacioni i të cilave është dërguar në organet e varësisë administrative.

4. Vendimet nr.312, datë 30.6.1994 të Këshillit të Ministrave "Për çmimin e truallit që shitet dhe qiranë e truallit që u jepet në përdorim për ndërtim personave fizikë dhe juridikë" dhe nr. 562, datë 9.10.1995 të Këshillit të Ministrave "Për shitjen e truallit të ndërmarrjeve që privatizohen", si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.172, datë 13.3.2003

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar me ligjin nr.8935, datë 12.9.2002, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit dhe të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a. Në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, në klasifikimin “B3” shtohet emërtimi “Nënprefekt”.

b. Në lidhjen II-12 “Niveli i pagave për punonjësit e prefekturës”, pas numrit rendor “2” shtohet numri rendor “2/1”, me emërtimin “Nënprefekt”, klasifikimi “B3”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.184, datë 20.3.2003

**PËR RREGULLAT DHE VEPRIMET E ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE DHE PËR
DETYRIMIN E SHITESASVE PËR TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE TË GJENDJES
CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 12 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Transferimi i të dhënave të gjendjes civile, në një zyrë tjetër të gjendjes civile, bëhet me kërkesën e kryefamiljarit. Për këtë, kryefamiljari duhet të paraqesë pranë zyrës së gjendjes civile të vendbanimit të ri këto dokumente:

a) Kërkesën me shkrim për regjistrim në vendbanimin e ri.

b) Dokumentin e pronësisë së banesës ose një kontratë qiramarrje, të paktën njëvjeçare. Deri në datën 28.11.2003, në mungesë të një dokumenti pronësie ose qiramarrjeje të banesës, shtetasi paraqet vërtetimin nga kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes ose kryetari i bashkisë, në qytetet pa lagje, ku ai shprehet se shtetasi banon në fshatin ose qytetin përkatës. Ky vërtetim lëshohet mbi bazën e njohjes së gjendjes ose verifikimit në vend të vendbanimit të shtetasit, jo më vonë se 10 ditë nga kërkesa e bërë nga shtetasi për këtë veprim.

c) Certifikatën familjare nga zyra e gjendjes civile e vendbanimit të mëparshëm.

2. Zyra e gjendjes civile e vendbanimit të ri i kërkon zyrtarisht, sipas formularit model nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, zyrës së gjendjes civile të vendbanimit të mëparshëm, dokumentin përkatës (fletëfamiljen) të të shpërngulurit.

3. Zyra e gjendjes civile e vendbanimit të mëparshëm dërgon zyrtarisht, fletëfamiljen e të shpërngulurit, në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të ri, e cila shoqërohet me formularin model nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Zyra e gjendjes civile e vendbanimit të ri, pasi merr në dorëzim nga zyra e gjendjes civile të vendbanimit të mëparshëm, fletëfamiljen e të shpërngulurit, bën regjistrimin e familjes në regjistrin themeltar dhe njofton zyrtarisht, sipas formularit model nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të mëparshëm, për të bërë çregjistrimin e kësaj familjeje nga regjistri themeltar.

5. Zyra e gjendjes civile e vendbanimit të mëparshëm, pasi merr njoftimin e regjistrimit të shtetasit në regjistrin themeltar të vendbanimit të ri, e çregjistron shtetasin nga regjistri i saj themeltar, duke i hequr vizë dhe duke shënuar në rubrikën e vërejtjeve adresën e regjistrit themeltar të vendbanimit të ri. Brenda 10 ditëve, zyra e gjendjes civile të vendbanimit të mëparshëm, njofton qendrën ose degën e mobilizimit në juridiksionin e së cilës ajo ndodhet, për transferimin e kryer, duke dhënë adresën e familjes në regjistrin themeltar të zyrës së gjendjes civile të vendbanimit të ri, sipas formularit model nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Çdo zyrë e gjendjes civile mban evidencën e kërkesave të paraqitura zyrave të tjera, për transferimin e të dhënave të gjendjes civile.

7. Ngarkohen strukturat e shërbimit të gjendjes civile në prefektura, bashki, njësitë bashkiake të Tiranës dhe komuna për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimi nr.14, datë 24.1.1994 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Model 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia/Njësia Bashkiake/Komuna _____
Nr. _____ Prot.Datë, _____

Zyrës së gjendjes civile _____

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____, në bazë të kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga kryefamiljari, z. _____, për të bërë transferimin e të dhënave të gjendjes civile të familjes së tij të përbërë nga _____ persona, që është regjistruar në regjistrin themeltar të zyrës suaj në nr. _____ fleta _____, kërkojmë të na dërgoni fletëfamiljen.

Nëpunësi i gjendjes civile

(Emri, mbiemri, nënshkrimi)

Model 2

Republika e Shqipërisë
Bashkia/Njësia Bashkiake/Komuna _____
Nr. _____ Prot.Datë, _____

Zyrës së gjendjes civile _____

Në përgjigje të shkresës suaj, nr. _____, prot, datë _____, në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____, në bazë të kërkesës së paraqitur nga zyra juaj, bashkëngjitur ju dërgojmë fletëfamiljen e kryefamiljarit, z. _____ të përbërë nga _____ persona.

Lutemi të na njoftoni marrjen në evidencë, si dhe regjistrin dhe fletën e regjistrit themeltar ku u transkriptua.

Nëpunësi i gjendjes civile

(Emri, mbiemri, nënshkrimi)

Model 3

Republika e Shqipërisë

Bashkia/Njësia Bashkiake/Komuna _____

Nr. _____ Prot.Datë, _____

Zyrës së gjendjes civile _____

Në përgjigje të shkresës suaj, nr. _____ prot, datë _____, në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____, ju njoftojmë se nga zyra jonë, u mor në evidencë fletëfamilja e kryefamiljarit, z. _____.

Regjistrimi u bë në regjistrin themeltar _____, në fletën _____, prandaj bëni çregjistrimin nga regjistri juaj themeltar.

Nëpunësi i gjendjes civile

(Emri, mbiemri, nënshkrimi)

Model 4

Republika e Shqipërisë

Bashkia/Njësia Bashkiake/Komuna _____

Nr. _____ Prot.Datë, _____

Qendrës së mobilizimit ushtarak të rrethit _____

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____, ju njoftojmë se zyra jonë, ka bërë çregjistrimin nga regjistri themeltar të familjes së kryefamiljarit, z. _____, të përbërë nga:

Nr	Emri Mbiemri	Lidhja me kryefam.	Seksi	Atësia	Mëmësia	Datëlindja	Vendlindja	Gjendja civile
1								
2								
3								
4								
5								

6								
7								
8								

Ju njoftojmë se regjistrimi u bë në regjistrin themeltar të zyrës së gjendjes civile të _____, rrethi _____, në regjistrin _____, në fletën _____.

Nëpunësi i gjendjes civile

(Emri, mbiemri, nënshkrimi)

V E N D I M
Nr.187, datë 20.3.2003

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LIBRAZHD-QUKËS, NË QARKUN E
ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Librazhd–Qukës, në qarkun e Elbasanit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 1149 m2 tokë/arë, 221 m2 tokë/truall, 101 copë dru frutorë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 476 180 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.
 5. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve, që vërtetojnë pronësinë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.4.2003.
 7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU: ELBASAN

**LISTA E PRONARËVE (SHITESË E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.234, DATË 13.3.2001) TË CILËT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “LIBRAZHD-QUKËS”**

Lloji i pasurisë: truall, tokë bujqësore dhe dru frutore

Nr	Pronari			Nr.pas	Truall			Tokë bujqësore			Dru frutore		Totali	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri		Sip	L/m2	Vlerë	Sip	L/m	Vlerë	Cop	Vlerë	Lekë	

								2		ë				
1	Destan	Selim	Sina							11	55000	55000		
2	Jonuz e Arif	Isak	Gjokola	8/114	221	1000	221000					221000		
3	Jani	Harun	Sina					621	320	198720	16	142000	340720	Proces regjistrimi
4	Sefer	Qazim	Cela	679				288	320	92160			92160	
5	Halil	Ymer	Gura	46				240	320	76800			76800	
6	Harun		Sina								16	130000	130000	
7	Shaban		Sina								20	149500	149500	
8	Sami		Sina								8	92000	92000	
9	Lutfi		Quku								7	45000	45000	
10	Sami		Kryeziu								5	100000	100000	
11	Hamdi		Kryeziu								3	60000	60000	
12	Rudina		Sina								15	114000	114000	
		Shuma			221	1000	221000	1149	960	367680	101	887500	1476180	
							0							

Mbyllet me nr. rendor 12 (dymbëdhjetë)
Vlefta totale e shpronësimit 1 476 180 lekë

V E N D I M
Nr.188, datë 20.3.2003

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2003**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2003, në shumën 155 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë) lekë, sipas strukturës në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1

**STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2003**

Nr	Emërtimi	Lekë
	Shpenzime gjithsej	155 000 000
1	Paga	18,834.000
2	Kontributi i sigurimeve shoqërore	3,794.000
3	Materiale	9,338.000
4	Shërbime	13,034.000
5	Investime	110,000.000

V E N D I M
Nr.189, datë 20.3.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESAT MBI PAGË TË
USHTARAKËVE NË SHËRBIMIN INFORMATIV SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1999 të Këshillit të Ministrave, pagat për funksionet e mëposhtme ndryshohen si më poshtë vijon:
 - Inspektor i Përgjithshëm në Shërbimin Informativ Shtetëror 105 000 lekë
 - Drejtor drejtorie në aparatin qendror;
Shef kabineti
 - Drejtori i Drejtorisë së Tiranës 80 000 lekë
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, zëri “Paga” miratuar për Shërbimin Informativ Shtetëror.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.4.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.190, datë 20.3.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E KUFIJVE TË SASISË SË FARËRAVE, QË LEJOHEN TË
SHKËMBEHEN PËR QËLLIME SHKENCORE DHE EKSPERIMENTALE, SI DHE ATO QË
NDALOHEIN TË SHKËMBEHEN PËR KËTË QËLLIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës bimor” me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kufijtë e sasisë së farërave, që lejohen të shkëmbehen për qëllime shkencore dhe eksperimentale, me institucionet shkencore jashtë vendit ose me persona fizikë dhe juridikë të huaj, si dhe ato që ndalohen, përcaktohen respektivisht në pasqyrat nr.1 dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
 2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Pasqyra nr.1

Sasitë e farës që lejohen të shkëmbehen për qëllime shkencore dhe eksperimentale

Nr.	Kultura	Sasia e farës
1	Grurë i butë	8 kg
2	Grurë i fortë	8 kg
3	Thekër	8 kg
4	Tritikale	8 kg
5	Elb polistik	8 kg
6	Elb distik	8 kg
7	Tërshërë	8 kg
8	Misër (për kokërr)	3 kg
9	Misër (sheqeror)	3 kg
10	Misër (kokoshkë)	3 kg
11	Misër (silazh)	3 kg
12	Sorghum (masë e gjelbër)	3 kg
13	Sorghum (për silazh)	3 kg
14	Orizi	3 kg
15	Fasulja	3 kg
16	Thjerrëza	3 kg
17	Soja	3 kg
18	Qiqra	3 kg
19	Bizelja (foragjere)	3 kg
20	Bizelja (perimore)	3 kg
21	Batha	3 kg
22	Panxhari i sheqerit	50 gr
23	Panxhari perimor	50 gr
24	Pambuku	2 kg
25	Luledielli	1 kg
26	Kikiriku	3 kg
27	Duhani	20 gr
28	Shalqini	50 gr
29	Pjepri	30 gr
30	Patëllxhani	20 gr
31	Spinaq	100 gr
32	Kungull	50 gr
33	Patatja	25 kg
34	Speci	20 gr
35	Qepa	50 gr
36	Domate	10 gr
37	Trangull	30 gr
38	Presh	50 gr
39	Hudhra	1 kg
40	Lakra	20 gr
41	Lulelakra	20 gr
42	Sallatë	10 gr
43	Karrota	50 gr
44	Bamje	3 kg
45	Rrepa	50 gr
46	Bishtajore njëvjeçare	2 kg
47	Graminore njëvjeçare	2 kg

48	Bishtajore shumëvjeçare	2 kg
49	Graminore shumëvjeçare	2 kg

Pasqyra nr.2

Lista e bimëve, farërat e të cilave nuk lejohet të shkëmbehen, sipas nenit 9 të ligjit nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope” janë:

Nr	Emri i bimës	Emri botanik
1	Hashashi	Papaver somniferum
2	Bima e kokës	Erythroxylum coca
3	Kërpi indian	Cannabis sativa var.indica

U D H Ë Z I M

Nr.8, datë 17.2.2003

PËR EVIDENCIMIN, REGJISTRIMIN, PËRDORIMIN DHE RAPORTIMIN E FINANCIMEVE TË HUAJA NË KUADRIN E PROJEKTEVE DHE MARRËVESHJEVE ME DONATORËT E HUAJ

Në mbështetje të ligjit organik të buxhetit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me procedurat e livrimit, regjistrimit, përdorimit dhe raportimit të fondeve të financimeve të huaja që realizohen në Republikën e Shqipërisë, në kuadrin e projekteve të investimeve publike, në formën e kredive të jashtme ose granteve, si dhe të marrëveshjeve të ndryshme për mbështetje ose asistencë teknike ose ndihmë në mallra për institucione të ndryshme buxhetore

U D H Ë Z O J:

1.Kuptimi mbi financimet e huaja

1.1 Financime të huaja – konsiderohen të gjitha ato burime financiare që i jepen Qeverisë Shqiptare ose institucioneve të tjera qeveritare ose publike, në formën e kredive ose ndihmave nga institucione financiare ndërkombëtare, qeveritë e vendeve të ndryshme ose institucione ose organizma jopublikë.

1.1 Kredi-janë të ardhura të marra me kusht kthimi me ose pa interes për financimin e projekteve të caktuara brenda fondeve të miratuara ose për financimin e deficitit buxhetor që jepen nga institucione financiare të huaja mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse që përdoren, shërbehen dhe shlyhen në përputhje me termat dhe kushtet e këtyre marrëveshjeve.

1.2 Ndhimë – janë të ardhura të përfituara në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, për një qëllim të përcaktuar ose jo, e cila përdoret për financimin e veprimtarive në përputhje me politika të caktuara dhe që jepen mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse nga institucione financiare, organizma të huaja, qeveri të vendeve të tjera, etj.

Procedurat ligjore të miratimit

2.1 Mbas negociimit dhe finalizimit të tekstit të çdo marrëveshje me donatorë të ndryshëm, ministrinë dhe institucionet qendrore paraqesin për miratim në Këshillin e Ministrave marrëveshjet e kredive, të ndihmave ose të granteve, si dhe gjithë dokumentet e tjera ligjore të lidhura me to, si dhe protokollet e negociatave, në rast se ka të tilla. Në vendimin që do të miratohet për këtë qëllim caktohen edhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjeve dhe projekteve përkatëse.

Marrëveshjet e kredisë ratifikohen detyrimisht në Parlament.

3. Hapja dhe mbajtja e llogarive të projekteve

3.1 Të gjitha të ardhurat nga huatë dhe ndihmat kur livrimi i tyre bëhet nëpërmjet transferimit të parave, do të kanalizohen nëpërmjet llogarive speciale të hapura në emër të Ministrisë së Financave për çdo projekt në Bankën e Shqipërisë. Llogaritë speciale nuk janë llogari pagesash, por vetëm për

kanalizimin dhe regjistrimin e disbursimeve të financimeve të huaja.

3.2 Njësitë e zbatimit paraqesin një kërkesë në Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit për çeljen e një llogarie speciale në Bankën e Shqipërisë. Kërkesa duhet të ketë këtë përmbajtje:

- emërtimi i projektit;
- lloji i financimit (ndihmë ose kredi);
- emri i donatorit ose kreditorit;
- monedha e disburimit;
- shuma e financimit të huaj;
- shuma e transhit të parë;
- koha e përafërt kur mbërrin transhi i parë.

Kërkesa për hapjen e kësaj llogarie shoqërohet me vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili ka miratuar marrëveshjen e ndihmës ose grantit ose ligjin që ka ratifikuar marrëveshjen e kredisë.

Ministri i Financave, me propozim të ministrit të linjës, njofton donatorin/kreditorin për personat e autorizuar për tërheqjen e fondeve nga kredia/granti.

3.3 Për njësitë e zbatimit që zgjedhin skemen e pjesshme të thesarit Ministria e Financave hap një llogari operative në një bankë të nivelit të dytë. Këto llogari hapen në emër të Ministrisë së Financave, me kërkesën e njësive dhe institucioneve zbatuese.

Ministri i Financave, me propozim të ministrit të linjës, i bën të ditur bankave për personat e autorizuar për lëvizjen e fondeve nga kjo llogari.

3.4 Për njësitë e zbatimit që zgjedhin skemën e plotë të thesarit përdorimi i fondeve kryhet nëpërmjet degëve të thesarit në rrethe.

4. Transaksionet

4.1 Të gjitha transaksionet që lidhen me financimet e huaja do të ndiqen, regjistrohen dhe raportohen nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore që janë në rolin e agjencive zbatuese, që nga momenti i nënshkrimit të tyre, livrimit, përdorimit dhe shlyerjes së tyre. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, nëpërmjet njësive të zbatimit të projekteve, janë të deyrura të raportojnë në Ministrinë e Financave të gjitha të dhënat e kërkuara në këtë drejtim brenda afateve të caktuara.

Për projektet me skemë të pjesshme të thesarit:

Me kërkesë të njësive të zbatimit ose agjencive zbatuese bëhet transferimi i fondeve nga llogaria speciale në Bankën e Shqipërisë, në llogaritë operative në bankat e nivelit të dytë të hapura për zbatimin e projektit.

4.3 Për projektet me skemën e plotë të thesarit:

Me mbërritjen e fondeve në llogaritë speciale, me kërkesë të njësive të zbatimit bëhet kalimi pjesor ose total i vlefave nga llogaritë speciale në llogarinë e depozitës së qeverisë në zërin “Financime të huaja”. Pas kësaj, Drejtoria e Thesarit dhe Borxhit bën autorizimin ku shënohet emri i plotë i projektit, shuma e transferuar në llogarinë e depozitës së qeverisë deri në transaksionin e fundit, shuma e transaksionit të fundit, shuma progresive e transferuar në llogarinë e depozitës së qeverisë deri në datën e fundit. Shuma e autorizimit të ri ndahet sipas strukturës buxhetore të projektit: Grup, titull, kapitull dhe artikull. Gjithashtu nga totali veçohet shuma që i përket vitit në vazhdim.

Autorizimet për shpenzimet e lëshuara nga Drejtoria e Thesarit dhe Borxhit (për projektet që funksionojnë me skemën e plotë të thesarit) konsiderohen si plan për njësinë e zbatimit dhe për shumën përkatëse, dega e buxhetit bën çeljen për degën e thesarit, sipas strukturës buxhetore të miratuar, dhe që paraqitet në autorizimin përkatës.

Çelja e fondeve të financimeve të huaja bëhet në zërin investime, por ndjekja dhe regjistrimi kryhet nga njësia e zbatimit dhe nga dega e thesarit, sipas natyrës së shpenzimit.

Njësitë e zbatimit të projekteve duhet të paraqesin pranë degëve të buxhetit një kopje të autorizimit të lëshuar nga Ministria e Financave, që u jep të drejtën për të shpenzuar nga këto fonde, si dhe një letër zyrtare ku detajohet vlefata e autorizimit në formën “Shtim-pakësim”.

Shuma e detajuar për çdo rreth do të konsiderohet si shtesë fondi për shpenzim në rrethin përkatës. Totali i të gjitha shumave të detajuara për të gjitha rrethet duhet të jetë i barabartë ose më i vogël se shuma që përmban autorizimi i lëshuar nga Ministria e Financave. Për rastet kur detajimi është më i vogël se vlefata totale e autorizimit të lëshuar, detajimi i shumës tjetër bëhet me një fraksion në vijim të detajimit fillestar dhe në çdo rast do të ketë bashkëngjitur fraksionet e mëparshme. Gjithashtu nga njësia e zbatimit në qendër kundrejt vlefave të shtuara në rrethe, në të njëjtën masë do të bëhet pakësimi i autorizimit (pra sa mbetet disponibël për t’u shpërndarë në rrethe).

Njësive të zbatimit të projekteve, duke qenë urdhëruese të fondeve, u lind e drejta për të bërë transferime fondesh nga një rreth në tjetrin. Në degën e buxhetit ku do të bëhet shtimi duhet të paraqiten:

- a) Kopje e autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Thesarit dhe Borxhit.
- b) Kopje e detajimit fillestar të bërë nga njësia e zbatimit.
- c) Konfirmim nga dega e buxhetit ku bëhet pakësimi që i konfirmon degës përkatëse ku bëhet shtimi.

Detajimi i autorizimeve në rrethe dhe transferimet e bëra nga njësitë e zbatimit të projekteve kërkojnë saktësi dhe rregullsi. Në rast të kundërt, degëve të buxhetit u lind e drejta të pezullojnë veprimin dhe në asnjë rast të mos bëjnë ekzekutime pjesore.

Njësitë e zbatimit të projekteve në fund të vitit duhet të bëjnë rakordim me degët përkatëse të thesarit në rrethe për fondet e çelura dhe shpenzimet e kryera. Për këtë bëhet një aktrakordim i firmosur nga përfaqësuesit e dy palëve. Ky aktrakordim do të përmbajë për çdo rreth:

- a) shumat e çelura nga njësitë e zbatimit të projekteve me shtesat e pakësimet sipas autorizimeve të MF-së;
- b) shumat e shpenzuara;
- c) diferencat midis fondeve të detajuara dhe shpenzimeve faktike.

Një kopje e këtij aktrakordimi dërgohet në Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit së bashku me evidencën e fundit të vitit.

Për fondet e papërdorura në fund të vitit, dega e buxhetit mbështetur në akt rakordimin e mësipërm, ribën çeljen në fillim të vitit tjetër, për vlerën e pashpenzuar në rrethin përkatës, duke i dhënë përparësi shpenzimeve të këtyre fondeve pas verifikimeve të domosdoshme.

4.4 Pavarësisht nga skemat e përdorura të thesarit, një pjesë e projekteve me financim të huaj janë në bashkëfinancim me Buxhetin e Shtetit, nga i cili përfitojnë fondet për TVSH-në, si dhe për kosto lokale. Këto shpenzime regjistrohen në strukturat përkatëse të buxhetit, në zërin investime dhe veprohet njëjloj si shpenzimet e tjera buxhetore të këtij klasifikimi.

Regjistrimi dhe raportimi

5.1 Njësitë e zbatimit në përputhje me marrëveshjen realizojnë pagesat përkatëse dhe raportojnë në Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit në Ministrinë e Financave, për disbursimet nga jashtë, transferimet në llogaritë në bankat e nivelit të dytë, shpenzimet e kryera nga këto llogari, si dhe gjendjet respektive të llogarive që disponohen në emër të projektit (llogarive speciale dhe llogarive operative).

5.2 Disburimet e financimeve të huaja do të regjistrohen si të hyra të Buxhetit të Shtetit. Huatë dhe ndihmat që livrohen në natyrë, për shkak se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e kreditorit/donatorit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet në bazë të njoftimeve të marra nga donatori dhe agjencia zbatuese e projektit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në marrëveshjen përkatëse, si dhe ato të përcaktuara nga Ministria e Financave me këtë udhëzim.

5.3 Shpenzimi i huave dhe ndihmave të livruara do të regjistrohen në shpenzimet e Buxhetit të Shtetit. Për huatë që do të livrohen nëpërmjet llogarive speciale në Bankën e Shqipërisë, transferimet e bëra nga këto llogari në llogaritë e thesarit ose drejtpërdrejt të përfituesve të kredisë ose ndihmave në bankat e nivelit të dytë, do të konsiderohen si xhirime të brendshme, ndërsa shpenzimi i tyre do të konsiderohet dhe raportohet i kryer, kur një gjë e tillë është njoftuar nga degët e thesarit në rrethe (është bërë pagesa nga llogaritë e thesarit) dhe njësitë e zbatimit të projekteve (është bërë pagesa nga llogaria operative e njësisë). Kur huatë dhe ndihmat livrohen në natyrë, në të njëjtën kohë që do të regjistrohen si të ardhura (të hyra) në buxhet, do të regjistrohen edhe si shpenzime (të dala) të buxhetit në bazë të njoftimeve të pagesave të kryera për blerjen e mallrave apo shërbimeve përkatëse nga kreditori/donatori ose informacionit që paraqet njësia përkatëse e zbatimit të projektit.

5.4 Ndhimat në natyrë ose në para që institucione të ndryshme shtetërore ose publike, ose hallka të ndryshme në vartësi të tyre, marrin nga shtete të tjera ose institucionet e tyre, shoqata dhe kompani ose individë të huaj, detyrimisht do të regjistrohen e kanalizohen nëpërmjet llogarive të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit nëpërmjet degëve të thesarit.

5.5 Brenda datës 5 të çdo muaji, çdo njësi e zbatimit të projekteve duhet të paraqesë në Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit në Ministrinë e Financave, situacionin e raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin paraardhës, progresiv për projektet respektive që ato mbulojnë. (Standardi i situacionit të raportimit është bashkëlidhur këtij udhëzimi)

Çdo institucion, duhet të raportojë në të njëjtën mënyrë dhe afat për projektet me financim të huaj që ai realizon, por për të cilat nuk është ngritur njësi zbatimi.

6. Masat për moszbatim të udhëzimit

6.1 Në zbatim të këtij udhëzimi, kërkohet marrja e të gjitha masave nga të gjithë titullarët e ministrive dhe institucioneve qendrore dhe gjitha strukturave të administratës shtetërore dhe asaj vendore, për zbatimin me rigorozitet të afateve kohore për dërgimin e raportimeve mujore në lidhje me financimet e huaja.

6.2 Në rastet e konstatimeve të qëndrimeve që kanë të bëjnë me mosrespektimin e afateve kohore apo pasaktësi në raportimin mujor, duke iu referuar legjislacionit në fuqi, do të procedohet me masa administrative.

6.3 Në rast se ministritë, institucionet e tjera qendrore, organet e pushtetit vendor dhe institucionet në vartësi të tyre marrin dhe shpenzojnë ndihma dhe hua pa i regjistruar në llogaritë përkatëse të Buxhetit të Shtetit nëpërmjet sistemit të thesarit, Ministria e Financave bën pakësimin e menjëhershëm të fondeve buxhetore të akorduara për vlefshëm e ndihmës dhe huasë së shpenzuar prej tyre.

6.4 Përveç sa më sipër, në raste të tilla Ministria e Financave do të pezullojë kryerjen e transaksioneve nga degët e thesarit për llogari të këtyre institucioneve, ose strukturës administrative qendrore ose vendore, në varësinë e të cilave janë projektet, deri në nxjerrjen e përgjegjësisë direkte dhe marrjen e masave ndaj shkaktarëve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Kastriot Islami

SITUACIONI I RAPORTIMIT

Institucioni qendror nga varet njësi e zbatimit të projektit _____

Emri i projektit _____ Kodi _____

Donatori/Kreditori _____

Nr. llogarisë speciale në BSH _____ në _____ (monedha)

Nr. llogarisë dhe banka e nivelit të dytë _____

1. Gjendja më 01.01.200X _____ në llog. Nr. _____ pranë bankës _____

2. Disbursuar gjatë periudhës 1 janar _____

Grup, Titull, Kapitull, Artikull

- Direkte (në llogarinë speciale në BSH)

- Indirekte

3. Transferuar në llogarinë në bankën e nivelit të dytë _____

4. Shpenzuar gjatë periudhës 1 janar _____

Grup Titull Kapitull Artikull Total Artikulli

_____ 600, 601, 602, 604, 230, 231, 232 _____

5. Gjendja në fund të periudhës raportuese në llogarinë e bankës së nivelit të dytë

Shpjegimi i termave të përdorura në këtë raportim është:

Disbursime: konsiderohen të gjitha të ardhurat (hyrjet në para ose në natyrë) nga çdo donator ose kreditor në favor të projektit përkatës.

Disbursime direkte: konsiderohen të gjitha të ardhurat që vijnë fizikisht në vendin tonë.

Disbursime indirekte: konsiderohen të gjitha të ardhurat disponibël që adresohen për llogari të projektit e shpenzohen direkt nga donatori ose kreditori pa u bërë hyrje në Shqipëri. Këto lloje të ardhurash janë në çdo rast të barabarta me shpenzimet indirekte.

Shpenzime: konsiderohen të gjitha pagesat e kryera në emër të projektit.

Shpenzime direkte: konsiderohen të gjitha pagesat që kryhen nga njësi e zbatimit të projektit

nga llogaritë operative në bankat e nivelit të dytë.

Shpenzime indirekte: konsiderohen të gjitha pagesat që kryhen direkt nga donatori ose kreditori pa u bërë hyrje në vendin tonë.

Në lidhje me zërin “Gjendja në fund të periudhës raportuese” duhet të bashkëlidhet një fotokopje e ekstraktit të datës së fundit të postës së bankës, në të cilën evidencohet shuma e pasqyruar në raportim.

Kuadratura e situacionit të raportimit është si më poshtë:

A. Gjendja më 01.01.2000X e llogarisë së njësisë së zbatimit të projektit në bankën e nivelit të dytë+Transferimet në llogarinë në bankën e nivelit të dytë–Shpenzimet direkte = Gjendja në fund të periudhës raportuese.

Disbursimet indirekte=Shpenzimet indirekte

Shënim: Në situacionin e raportimit të sqarohet nga mbushet llogaria në lekë që është në bankën e nivelit të dytë (direkt nga llogaria në valutë në bankë ose llogaria speciale në BSH).

Raportimi lidhet vetëm me shpenzimet dhe të ardhurat e vitit dhe jo nga fillimi i veprimtarisë së projektit.

U R D H Ë R
Nr.17, datë 15.1.2003

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË PESHKIMIT
(OMP POGRADEC)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 31/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”.

V E N D O S I:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Pogradec, që i bashkëngjitet këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE USHQIMIT
AGRON DUKA

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 24.3.2003

Doli nga shtypi më 25.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë